



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministrastvo Administracije lokalne Samupravo*  
*Ministry of lokal government Administration*

---

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 neni 15 paragrafi 2 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Shpall

**K O N K U R S**

<b>Titulli i vendit të punës:</b>	Zyrtar i lartë i personelit
<b>Departamenti:</b>	Financa dhe Shërbime të Përgjithshme
<b>Divizioni:</b>	<b>Burime Njerëzore</b>
<b>Orari i punës:</b>	Orar i plotë i punës
<b>Koeficienti:</b>	8
<b>Raporton tek:</b>	<b>Menaxheri i personelit</b>
<b>Lloji i pozitës:</b>	Jo karrierës
<b>Mbikëqyrja e stafit:</b>	<b>Nuk ka</b>
<b>Referenca:</b>	<b>PE/020</b>

**Qëllimi i vendit të punës :**

Zhvillimi i procedurave të rekrutimit për stafin e MAPL-se dhe sigurimi i zbatimit të ligjit në shërbimin civil.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

1. Kujdeset për kompletimin e dosjeve personale dhe freskimin e tyre;
2. Kujdeset për hartimin dhe zbatimin e planeve vjetore të pushimeve;
3. Pranon verifikon aplikacionet e kandidatëve për pozitat e shpallura;
4. Përgatit dokumentacionin e nevojshëm për komisionet për procedurat e rekrutimit;
5. Kujdeset për menagjimin e pushimeve vjetore, mjekësore dhe të tjera të stafit;
6. Përditëson dosjet personale me të dhëna dhe kujdeset që të gjitha llojet e pushimeve të stafit janë në pajtim me ligjin
7. Përgadite raporte të punës periodike sipas kërkesës.
8. Kryen edhe detyra tjera të cilat kohe pas kohe kërkohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë

**Kualifikimi dhe përvoja:** (Kualifikimet, përvoja si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës)

- Diplomë universitare në drejtësi ,ekonomi /minimum 3 vite përvojë pune profesionale.
- Aftësi komunikuese, negociuese ;
- Shkathtësi në caktim të objektivave , planifikim të punës dhe analizë ;
- Shkathtësi në analitike dhe vlerësim të informacionit;

-Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

### **Aktet ligjore dhe aktet nën-ligjore që rregullojnë rekrutimin**

Rekrutimin e nëpunësve civil e rregullon Ligji Nr. 03/L -149 Për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Rregullorja Nr.02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil .

### **Kohëzgjatja e emërimit**

Kohëzgjatja e emërimit-Jo e karrjeres për 6(gjashtë) muaj, në të cilën është e përfshirë periudha e punës provuese tre mujore.

### **Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve**

Formularët zyrtar për aplikim merren në Zyrën e Personelit të MAPL-së, Kati XII -zyra 1203 , ndërtesa e ish-Rilindja, gjithashtu mund të tërhiqen edhe nga ueb -Faqja e MAPL -së.

### **Kushtet për pjesëmarrje në rekrutim**

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat dhe Vërtetimin nga Gjykata që personi nuk është nën hetime etj, mund të dorëzohen drejtpërdrejtë në Zyrën e Personelit të MAPL-së dhe përmes postës.

**-“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”,**

**-“Komunitet jo- shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11,pragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikë së Kosovës”**

**-Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.**

**-Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.**

### **Procedura e Konkurimit**

Procedura e konkurimit është e jashtme dhe të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit përkatsisht nga data 06.12.2016 deri më 20.12.2016.

Konkursi dhe kërkesa për punësim janë të publikuara edhe në ueb-Faqen e Ministrisë:

**[mapl.rks-gov.net](http://mapl.rks-gov.net)**

Për informata shtesë mundë të kontaktoni Zyrën e Personelit të MAPL-së, në telefonin: **038-200 35-568**.